



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

**VENDIM**

**Nr.31, datë 4.4.2018**

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES “Mbi planet e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të nenit 12, pikat 1 dhe 9, nenit 13, nenit 15 dhe nenit 87 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë rregulloren “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

**SEKRETARI**  
**Elvis ÇIBUKU**

**KRYETARI**  
**Gent SEJKO**

**RREGULLORE**  
**“MBI PLANET E NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME”**

(Miratuar me vendimin nr. 31, datë 4.4.2018 dhe ndryshuar me vendimin  
Nr 68, datë 25.11.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)

**KREU I**  
**TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë:

- a. përmbajtjen e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- b. procedurat për hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- c. procesin për vlerësimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

**Neni 2**  
**Subjektet**

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

**Neni 3**  
**Baza juridike**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a. nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b. nenit 12, pikat 1 dhe 9, nenit 13, nenit 15 dhe nenit 87 të ligjit nr. 133, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”).

**Neni 4**  
**Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 4 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”, si dhe në nenin 4 të rregullores nr. 72 datë 06.12.2017 “Për planet e rimëkëmbjes së bankave”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
- a. **Strategji e ndërhyrjes së jashtëzakonshme** është tërësia e veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të parashikuara në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
  - b. **Strategji e preferuar** është strategjia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme që mundëson në shkallën më të lartë të mundshme, përmbushjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të përcaktuara në nenin 20 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”.
  - c. <sup>1</sup>“ndërhyrja e jashtëzakonshme në nivel grupi bankar” nënkupton strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme që përfshin zbatimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në nivelin e bankës zotëruese të grupit bankar, pavarësisht juridiksionit të saj.
  - d. <sup>2</sup>“ndërhyrja e jashtëzakonshme individuale” nënkupton strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme që përfshin zbatimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në nivel individual të bankës që është pjesë e një grupi bankar.

## **Neni 5**

### **Kërkesa të përgjithshme**

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme harton planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për çdo bankë dhe grup bankar, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
2. Plani për ndërhyrjen e jashtëzakonshme parashikon veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme që ndërmerr Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme kur plotësohen kushtet për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

## **KREU II**

### **PËRMBAJTJA E PLANIT TË NDËRHJRJES SË JASHTËZAKONSHME**

## **Neni 6**

### **Struktura e planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme**

Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban të paktën elementët e mëposhtëm:

---

<sup>1</sup> Shtuar me vendimin Nr.68 dt. 25.11.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë

<sup>2</sup> Shtuar me vendimin Nr.68 dt. 25.11.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë

- a. përmbledhjen ekzekutive të planit sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje;
- b. analizën strategjike të bankës në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje;
- c. përshkrim të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje;
- d. përshkrim të kërkesës minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar, sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje;
- e. kërkesën për financim dhe burimet e financimit për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme të parashikuar në plan, sipas nenit 11 të kësaj rregulloreje;
- f. marrëveshjet për sigurimin e vazhdimësisë operacionale të funksioneve me rëndësi kritike dhe veprimtarive kryesore gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas nenit 12 të kësaj rregulloreje;
- g. përshkrim të informacionit dhe marrëveshjeve të nevojshme për sigurimin e tij, për përzgjedhjen dhe zbatimin efektiv të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje;
- h. planin e komunikimit me grupet e interesit, sipas nenit 14 të kësaj rregulloreje;
- i. përfundimet e vlerësimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme ose të likuidimit të detyruar, sipas nenit 15 të kësaj rregulloreje;
- j. opinionin e bankës mbi planin e kaluar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas nenit 16 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 7**

### **Përmbledhja ekzekutive në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme**

1. Përmbledhja ekzekutive në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përfshin përshkrimin e bankës ose grupit bankar dhe një përmbledhje të elementëve të parashikuar nga shkronja (b) deri në shkronjën (i), të nenit 6 të kësaj rregulloreje.
2. Kjo përmbledhje përmban, gjithashtu, edhe një përshkrim të çdo ndryshimi të rëndësishëm që ka ndodhur në bankë ose në grupin bankar që nga hera e fundit e hartimit të planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

## **Neni 8**

### **Analiza strategjike**

1. Analiza strategjike në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përfshin një përshkrim dhe përmbledhje të:

- a. strukturës së bankës/grupit bankar, të pronësisë dhe të qeverisjes;
- b. aktiveve, kapitalit, të ardhurave dhe strukturës së rreziqeve;
- c. modelit të biznesit të bankës dhe linjave të biznesit;
- d. funksioneve kritike, veprimtarive kryesore dhe shpërndarjes së tyre ndërmjet subjekteve të rëndësishme;
- e. ndërvarësive të brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë ato ligjore, financiare dhe operacionale;
- f. sistemeve kritike dhe infrastrukturës.

## **Neni 9**

### **Strategjia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme**

1. Strategjia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban një përshkrim të vlerësimit nëse likuidimi i detyruar është i besueshëm dhe i zbatueshëm, të kryer sipas nenit 18 të kësaj rregulloreje. Nëse procedura e likuidimit të detyruar është e besueshme dhe e zbatueshme, strategjia e preferuar është likuidimi i detyruar.
2. Nëse procedura e likuidimit të detyruar nuk është e besueshme dhe e zbatueshme, strategjia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban elementët në vijim:
  - a. identifikimin e strategjisë së preferuar dhe të instrumenteve përkatëse, sipas nenit 17, pika 2, të kësaj rregulloreje;
  - b. identifikimin e funksioneve me rëndësi kritike dhe veprimtarive kryesore të bankës, përfshirë veçimin e funksioneve me rëndësi kritike dhe veprimtarive kryesore të bankës për të cilat do të sigurohet vazhdimësia e tyre, nga funksionet dhe veprimtaritë e tjera të bankës;
  - c. vlerësimin e afateve kohore për ekzekutimin e çdo veprimi me rëndësi të planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
  - d. përshkrim të secilit variant të strategjisë së preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke identifikuar dhe adresuar rrethanat, në të cilat strategjia e preferuar nuk mund të zbatohet;
  - e. përshkrim të procesit të vendimmarrjes, duke përfshirë identifikimin e organeve vendimmarrëse të zbatimit të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, së bashku me afatet e nevojshme kohore për marrjen e vendimeve.
  - f. për grupin bankar, marrëveshjet e bashkëpunimit dhe koordinimit midis Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe autoriteteve kompetente të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të një shteti tjetër ose me organizata ndërkombëtare, të cilat janë përgjegjëse për ndërhyrjen e jashtëzakonshme ndaj një institucioni që është pjesë e një grupi bankar që vepron në Republikën e Shqipërisë ose anasjelltas, në

përputhje me procedurat dhe marrëveshjet e shkruara, të parashikuara në nenin 70 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”.

3. <sup>3</sup>Në veçanti për grupet bankare, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson nëse është më i përshtatshëm zbatimi i strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme në nivel grupi bankar apo zbatimi i strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme individuale. Për këtë qëllim, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson:
- a. instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme që do të përdoren në strategjinë e preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe nëse këto instrumente mund të përdoren për subjektet e grupit;
  - b. vlerën e instrumenteve, rrezikun që këto instrumente të mos përdoren për përthithjen e humbjeve ose rikapitalizim, si dhe subjektet që kanë emetuar detyrimet e pranuar sipas strategjisë së propozuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke marrë në konsideratë se:
    - i. “ndërhyrja e jashtëzakonshme në nivel grupi bankar” mund të jetë më e përshtatshme nëse detyrimet e pranuar apo detyrimet që priten të kontribuojnë në përthithjen e humbjeve ose rikapitalizim, të mbajtura nga kreditorë jashtë grupit bankar, sipas strategjisë së propozuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, janë emetuar në nivelin e mjaftueshëm nga banka mëmë;
    - ii. “ndërhyrja e jashtëzakonshme individuale” mund të jetë më e përshtatshme nëse detyrimet e pranuar apo detyrimet që priten të kontribuojnë në përthithjen e humbjeve ose rikapitalizim, sipas strategjisë së propozuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, janë emetuar nga më shumë se një subjekt i grupit.
  - c. marrëveshjet kontraktuale ose marrëveshje të tjera për transferimin e humbjeve ndërmjet subjekteve të grupit;
  - d. strukturën operacionale dhe modelin e biznesit të bankës ose grupit, dhe në veçanti, nëse grupi bankar është i integruar ose ka strukturë të decentralizuar me nivel të lartë veçueshmërie ndërmjet pjesëve të ndryshme të bankës ose të grupit, duke marrë në konsideratë se:
    - i. “ndërhyrja e jashtëzakonshme në nivel grupi bankar” mund të jetë më e përshtatshme nëse grupi operon në nivel të lartë integrimi, duke përfshirë administrim të integruar të likuiditetit, rrezikut, funksioneve të thesarit ose sistemit të informacionit dhe shërbime të tjera të përbashkëta të rëndësishme;
    - ii. “ndërhyrja e jashtëzakonshme individuale” mund të jetë më e përshtatshme nëse operacionet e grupit ndahen në pjesë të veçanta, ku secila është relativisht e pavarur (financiarisht, ligjrisht ose

---

<sup>3</sup> Shtuar me vendimin Nr.68 dt. 25.11.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë

operacionalisht) nga pjesët e tjera të grupit dhe çdo ndërvarësi kritike operacionale nga pjesët e tjera të grupit, bazohet në marrëveshje kontraktuale që garantojnë vazhdimësinë operacionale në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

- e. zbatueshmërinë e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në vendet e tjera;
- f. nëse strategjia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme kërkon veprime mbështetëse nga autoritetet përkatëse në vendet e tjera ose kërkon që këto autoritete të mos zbatojnë veprime të pavarura të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe nëse këto veprime janë të zbatueshme dhe të besueshme për këto autoritete.

#### **Neni 10**

##### **Kërkesa minimale për instrumentet e kapitalit dhe detyrimeve të pranuar**

Plani për ndërhyrjen e jashtëzakonshme përmban një përshkrim të kërkesës për nivelin minimal të instrumenteve të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar, sipas pikës 1 të nenit 32 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”.

#### **Neni 11**

##### **Kërkesat për financim dhe burimet e financimit për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme**

Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban një përshkrim të shkurtër të kërkesës për financim për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të modelit të bankës dhe të planit të kontigjencës për likuiditet, sipas elementëve në vijim:

- a. përshkrimin e kërkesës për financim, për fonde dhe për likuiditet, që parashikohet në strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- b. përshkrimin e burimeve të mundshme të financimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përfshirë termat/kushtet e financimit, kriteret për përdorimin e tij, kohën në të cilën është i disponueshëm, subjektet nga të cilat mund të përfitohet financim, si dhe kërkesat përkatëse për kolateral;
- c. aty ku është e përshtatshme, një përshkrim dhe analizë të procesit se si dhe kur banka mund të aplikojë për përdorimin e instrumenteve financiare të Bankës së Shqipërisë, në kushtet e trajtuara në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përfshirë edhe identifikimin e kolateralit përkatës.
- d. për grupet bankare, një përshkrim të parimeve të miratuara për ndarjen e përgjegjësisë së financimit ndërmjet nga burimeve të financimit në juridiksione të ndryshme.

#### **Neni 12**

## **Marrëveshjet për sigurimin e vazhdimësisë operacionale**

Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban një përshkrim të marrëveshjeve për sigurimin e vazhdimësisë operacionale të funksioneve me rëndësi kritike gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme në bankë. Ky përshkrim përfshin të paktën:

- a. sistemet dhe operacionet kritike të përbashkëta, të cilat janë të nevojshme për ruajtjen e vazhdimësisë së funksioneve me rëndësi kritike, si dhe të marrëveshjeve përkatëse për sigurimin e vazhdimësisë kontraktuale dhe operacionale të tyre gjatë zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- b. marrëveshjet për sigurimin e përdorimit të sistemeve të pagesave ose infrastrukturës së tregjeve financiare, të nevojshme për ruajtjen e vazhdimësisë së funksioneve me rëndësi kritike, përfshirë një vlerësim mbi sigurinë e të dhënave të sistemit të klerimit dhe mundësinë e transferimit të aktiveve dhe pozicioneve të klientëve në anëtarë të tjerë të sistemit.

### **Neni 13**

#### **Informacioni dhe marrëveshjet për ofrimin e tij**

Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban një përshkrim të informacionit dhe marrëveshjeve për sigurimin e këtij informacioni, të nevojshme për përzgjedhjen dhe zbatimin efektiv të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përfshirë të paktën:

- a. informacionin dhe proceset për marrjen në kohë të informacionit që nevojitet për vlerësimin për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në zbatim të nenit 24 dhe nenit 36 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka” si dhe për *marketing*-un e të drejtave, detyrimeve, aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë së bankës, në rastin e instrumentit të shitjes së aktivitetit tregtar dhe instrumentit të bankës urë;
- b. marrëveshjet për shkëmbimin e informacionit midis Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme me autoritete kompetente të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të një shteti tjetër ose me organizata ndërkombëtare, të cilat janë përgjegjëse për ndërhyrjen e jashtëzakonshme ndaj një institucioni që është pjesë e një grupi bankar që vepron në Republikën e Shqipërisë ose anasjelltas, sipas nenit 70 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”;
- c. marrëveshjet për të siguruar që informacioni i kërkuar në zbatim të neneve 12 dhe 13 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka” të sigurohet i përditësuar në kohën që kërkohet.

### **Neni 14**

#### **Plani i komunikimit**



1. Plani i komunikimit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme përfshin të paktën komunikimin me:

- a. drejtuesit ekzekutivë, pronarët (aksionerët) dhe personelin e bankës, duke përfshirë procedurat për konsultimin me personelin dhe sipas rastit, dialogun me partnerët socialë, të tillë si organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punonjësve, sindikatat dhe një vlerësim të ndikimit të planit mbi punonjësit;
- b. klientët, median dhe publikun e gjerë;
- c. depozituesit, zotëruesit e obligacioneve, kundërpalët, infrastrukturën e tregut financiar dhe pjesëmarrësit e tjerë të ndikuar të tregut;
- d. çdo organ administrativ ose gjyqësor nga i cili kërkohet miratim ose autorizim për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- e. çdo këshilltar që kërkohet për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

2. Mënyra e komunikimit dhe përmbajtja e informacionit që komunikohet, do të reflektojë rëndësinë që ka secili nga grupet e interesit për procesin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

## **Neni 15**

### **Përfundimet e vlerësimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme**

1. Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban përfundimet e vlerësimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe përfshin të paktën:
  - a. përshkrim të vlerësimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në kushtet aktuale, të kryer sipas nenit 17 të kësaj rregulloreje;
  - b. përmbledhje të vlerësimit nëse banka duhet t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit të detyruar, të kryer sipas nenit 18 të kësaj rregulloreje.
  - c. përshkrim të çdo pengese të identifikuar ndaj aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe masat e propozuara nga banka ose të kërkuara nga Autoriteti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme,<sup>4</sup> në përputhje me objektivat dhe parimet e përcaktuara në Aneksin 2 të kësaj rregulloreje, për trajtimin ose heqjen e këtyre pengesave.
  - d. vlerësim sasior të çdo ndryshimi në nivelin minimal të instrumenteve të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar ose evidentimin e saktë të detyrimeve të pranuar që kërkohen për trajtimin ose heqjen e pengesave për ndërhyrje të jashtëzakonshme, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore

---

<sup>4</sup> Shtuar me Vendimin Nr.68 dt. 25.11.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë

të miratuara në zbatim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”.

2. Për bankat, për të cilat Autoriteti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme vlerëson se likuidimi i detyruar është i besueshëm dhe i zbatueshëm, plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban përmbledhjen për këtë vlerësim. Për bankat e tjera, plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban të gjithë elementët e specifikuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 16**

### **Opinionin mbi planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme**

1. Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban opinionin e shprehur nga banka në lidhje me planin e kaluar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dërgon zyrtarisht një përmbledhje të elementëve kryesorë të planit përkatës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme pranë secilës bankë.
2. Banka dërgon opinionin e saj mbi planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e përmbledhjes së planit nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.<sup>5</sup>Në rastin e grupeve bankare, opinionin mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dërgohet nga banka mbizotëruese.

## **KREU III**

### **VLERËSIMI I AFTËSISË PËR NDËRHYRJE TË JASHTËZAKONSHME**

## **Neni 17**

### **Fazat e vlerësimit**

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, sipas fazave të mëposhtme:
  - a. së pari, kryhet vlerësimi i besueshmërisë dhe zbatueshmërisë së likuidimit të detyruar të bankës, në përputhje me nenin 18 të kësaj rregulloreje;
  - b. së dyti, bëhet përzgjedhja e strategjisë së preferuar për ndërhyrje të jashtëzakonshme, në përputhje me nenin 19 të kësaj rregulloreje;
  - c. së treti, kryhet vlerësimi i besueshmërisë së strategjisë së preferuar për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, në përputhje me nenin 20 të kësaj rregulloreje;

---

<sup>5</sup> Shtuar me Vendimin Nr.68 dt. 25.11.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë

- d. së katërtri, kryhet vlerësimi i zbatueshmërisë së strategjisë së preferuar për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në përputhje me nenet 21 deri në 26 të kësaj rregulloreje.
2. Nëse Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme arrin në përfundimin se likuidimi i detyruar i bankës, nuk është besueshëm dhe i zbatueshëm dhe se vendosja e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme është në interesin publik, ai identifikon strategjinë e preferuar për ndërhyrje të jashtëzakonshme që është e përshtatshme për bankën, në bazë të informacionit të dërguar nga banka, sipas pikës 5 të nenit 12, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka” dhe kritereve të përcaktuara në këtë rregullore. Në rast se është e nevojshme, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, identifikon strategjitë alternative për të adresuar rrethanat në të cilat strategjia e preferuar nuk është e zbatueshme dhe e besueshme.
  3. Vlerësimi i besueshmërisë dhe zbatueshmërisë së strategjisë së preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme përfshin dhe vlerësimin e strategjive alternative të propozuara si pjesë të saj.
  4. Për vlerësimin e strategjisë së preferuar dhe strategjive alternative, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme kërkon nga banka informacion shtesë në përputhje me nenin 12 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”. Aty ku është e përshtatshme, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme rishikon strategjinë e preferuar ose konsideron strategji alternative në bazë të vlerësimit të plotë të besueshmërisë dhe zbatueshmërisë së strategjisë së preferuar, sipas pikës 2 të këtij neni.
  5. Nëse Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme rishikon strategjinë e preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, vlerëson besueshmërinë dhe zbatueshmërinë e strategjisë së preferuar për ndërhyrje të jashtëzakonshme të rishikuar, përkatësisht sipas neneve 19 dhe 25 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 18**

### **Besueshmëria dhe zbatueshmëria e likuidimit të detyruar**

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson besueshmërinë dhe zbatueshmërinë e likuidimit të detyruar të bankës, duke konsideruar nëse likuidimi i detyruar përmbush në të njëjtën shkallë objektivat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si ndërhyrja e jashtëzakonshme,.
2. Në vlerësimin e besueshmërisë së likuidimit të detyruar, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme konsideron ndikimin e mundshëm që mund të ketë likuidimi i detyruar i bankës në sistemin financiar, me synimin e ruajtjes së vazhdimësisë operacionale të funksioneve me rëndësi kritike dhe përmbushjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme sipas nenit 20 ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshmenë banka”. Për këtë qëllim, Autoriteti i Ndërhyrjes së

Jashtëzakonshme mban në vëmendje funksionet e kryera nga banka dhe vlerëson nëse likuidimi ka efekt negativ në:

- a. ekonominë reale dhe në veçanti funksionet kritike;
  - b. funksionimin e tregjeve financiare, infrastrukturën e tyre si dhe në veçanti, efektin zinxhir të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë ndaj institucioneve të tjera financiare;
  - c. mbrojtjen e fondeve publike, fondeve të klientëve të bankës dhe aktiveve të klientëve të bankës.
3. Nëse Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme arrin në përfundimin se likuidimi i detyruar është i besueshëm, ai duhet të vlerësojë zbatueshmërinë e tij.
4. Për vlerësimin e zbatueshmërisë së likuidimit të detyruar, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson nëse sistemet e bankës mund të ofrojnë informacionin e kërkuar nga skema e sigurimit të depozitave me qëllim kryerjen e pagesave për depozitat e siguruara, në sasinë dhe afatet e përcaktuara në ligjin “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka” dhe në ligjin nr. 53/2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, gjithashtu, vlerëson nëse banka ka kapacitetin e nevojshëm për mbështetjen e veprimeve të skemës së sigurimit të depozitave, veçanërisht për veçimin e depozitave të siguruara nga ato të pasiguruara.

## **Neni 19**

### **Identifikimi i strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme**

1. Në rastet kur në përputhje me pikën 4 të nenit 21 dhe nenin 65 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”, ndërmarrja e veprimit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme argumentohet me përmbushjen e interesit publik, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme identifikon strategjinë e përshtatshme dhe instrumentet përkatëse për përmbushjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke marrë në konsideratë strukturën dhe modelin e biznesit të bankës.
2. Veprimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme ndërmerret në interes publik nëse ai është i domosdoshëm për përmbushjen në mënyrë proporcionale të një ose më shumë objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe kur likuidimi i detyruar i bankës nuk mund t’i përmbushë në të njëjtën shkallë këto objektiva.

## **Neni 20**

### **Vlerësimi i besueshmërisë së strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme**

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson besueshmërinë e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme duke marrë në konsideratë ndikimin që ka ndërhyrja e jashtëzakonshme në sistemin financiar dhe ekonominë reale, për sigurimin e vazhdimësisë së funksioneve me rëndësi kritike të bankës. Ky vlerësim përfshin shqyrtimin e çështjeve të adresuara në pikën 20 deri 27 të Aneksit 1.
2. Për kryerjen e këtij vlerësimi, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme konsideron ndikimin që ka zbatimi i strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme në ekonominë reale dhe në sistemin financiar.

## **Neni 21**

### **Vlerësimi i zbatueshmërisë së strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme**

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson nëse strategjia e përzgjedhur e ndërhyrjes së jashtëzakonshme është efektivisht e zbatueshme në një afat kohor të përshtatshëm, si dhe identifikon pengesat e mundshme për zbatimin e saj.
2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mban në vëmendje pengesat për rivendosjen e qëndrueshmërisë financiare të bankës në periudhën afatshkurtër. Gjithashtu, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme konsideron çdo pengesë të mundshme ndaj planit për riorganizimin e aktivitetit tregtar të bankës, në zbatim të nenit 39 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”, ose ato masa që mund të kërkojnë në rast se strategjia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme parashikon rivendosjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të bankës ose të një pjese të saj.
3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme identifikon pengesat e mundshme për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të paktën për kategoritë e mëposhtme :
  - a. struktura dhe operacionet;
  - b. burimet financiare;
  - c. informacioni;
  - d. çështjet ndërkufitare;
  - e. çështjet ligjore.

## **Neni 22**

### **Vlerësimi i zbatueshmërisë: struktura dhe operacionet**

Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson nëse ka pengesa potenciale për ndërhyrjen e jashtëzakonshme lidhur me strukturën dhe operacionet e bankës, konsideron të paktën:

- a. çështjet e adresuara në pikat 1 deri në 7, pikat 16 dhe 18 të Aneksit 1.
- b. varësinë që kanë subjektet e rëndësishme dhe veprimtaritë kryesore ndaj infrastrukturës, teknologjisë së informacionit, funksioneve të financës apo thesarit, punonjësve apo shërbimeve të tjera të përbashkëta me rëndësi kritike;
- c. nëse qeverisja/administrimi, kontrolli dhe marrëveshjet për menaxhimin e rrezikut janë në përputhje me ndryshimet e planifikuara në strukturën e bankës;
- d. nëse struktura ligjore dhe e franshizës së bankës është në përputhje me ndryshimet e planifikuara në strukturën e biznesit të bankës;
- e. nëse ekzistojnë instrumente të përshtatshëm të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për çdo subjekt të grupit bankar, me qëllim zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

### **Neni 23**

#### **Vlerësimi i zbatueshmërisë: burimet financiare**

Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson nëse ka pengesa potenciale për ndërhyrjen e jashtëzakonshme lidhur me burimet financiare, konsideron ndër të tjera:

- a. çështjet e adresuara në pikat 13, 14, 15 dhe 17 të Aneksit 1;
- b. identifikimin sasior të detyrimeve, të cilat sipas strategjisë së preferuar për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, nuk kontribuojnë në përthithjen e humbjeve dhe rikapitalizimin e bankës, duke mbajtur në konsideratë minimalisht faktorët e mëposhtëm:
  - i. afatin e maturimit;
  - ii. radhitjen sipas hierarkisë së instrumenteve ;
  - iii. llojin e mbajtësve të instrumentit ose transferueshmërinë e instrumentit;
  - iv. pengesat ligjore për përthithjen e humbjeve, të tilla si mosnjohja e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme sipas legjisllacionit të huaj apo ekzistenca e të drejtës së kompensimit;
  - v. faktorë të tjerë që krijojnë rrezik që detyrimet të përjashtohen nga përthithja e humbjeve gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
  - vi. personat juridikë që emetojnë detyrime të pranuar apo detyrime të tjera dhe vlera e këtyre emetimeve, të cilat do të përdoren për përthithjen e humbjeve.

- c. nevojën për financim përpara dhe gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme, disponibilitetin e burimeve të financimit dhe pengesat për transferimin e fondeve brenda bankës apo grupit bankar;
- d. nëse ekzistojnë marrëveshje të përshtatshme për transferimin e humbjeve drejt subjekteve të grupit bankar mbi të cilët do të zbatohen instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme nga subjektet e tjera të grupit, duke përfshirë atje ku është e mundur, një vlerësim të shumës dhe kapacitetit përthithës të humbjeve nga financimi brenda grupit bankar.

#### **Neni 24**

##### **Vlerësimi i zbatueshmërisë: Informacioni**

Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson se ka pengesa potenciale për ndërhyrjen e jashtëzakonshme lidhur me marrjen e informacionit, konsideron të paktën:

- a. çështjet e adresuara në pikat 8 deri në 12 të Aneksit 1;
- b. aftësinë e bankës për të ofruar informacion mbi shumën dhe vendndodhjen brenda grupit bankar të aktiveve, të cilat klasifikohen si kolateral për marrjen hua nga banka qendrore;
- c. aftësinë e bankës për të dhënë informacion për realizimin e vlerësimit e shumës së nevojshme të zhvlerësimit ose të rikapitalizimit.

#### **Neni 25**

##### **Vlerësimi i zbatueshmërisë: çështjet ndërkufitare**

Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson nëse ka pengesa potenciale për ndërhyrjen e jashtëzakonshme lidhur me çështjet ndërkufitare, konsideron të paktën:

- a. çështjet e adresuara në pikën 19 të Aneksit 1;
- b. ekzistencën e proceseve të përshtatshme për koordinim dhe komunikim, për të siguruar që veprimet e ndërmarra midis autoriteteve vendase dhe të huaja mundësojnë zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- c. mënyrën sesi legjislacioni vendas dhe i huaj trajtojnë të drejtat kontraktuale të zgjidhjes së kontratave financiare, të cilat lidhen posacërisht me paftësinë paguese dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

#### **Neni 26**

##### **Vlerësimi i zbatueshmërisë: Çështje ligjore**

Për vlerësimin e pengesave potenciale për ndërhyrjen e jashtëzakonshme konsiderohen çështjet e mëposhtme ligjore që nuk janë përfshirë në kategoritë e tjera:

- a. nëse plotësohen në kohë kërkesat për autorizime apo miratime të autoriteteve rregullatore, të nevojshme për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- b. nëse me fillimin e procesit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, dokumentacioni kontraktual lejon zgjidhjen e kontratave;
- c. nëse detyrimet kontraktuale, të cilat nuk mund të shfuqizohen nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, ndalojnë transferimin e aktiveve dhe detyrimeve të përfshira në strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

#### **<sup>6</sup>Neni 26/1**

#### **Komunikimi me bankat mbi pengesat e mundshme**

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme i komunikon bankës pengesat e mundshme të identifikuara gjatë ciklit vjetor të hartimit të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
2. Në funksion të pikës 1 të këtij neni, banka harton një "Program pune mbi aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme" që miratohet nga Këshilli Drejtues, i cili përshkruan trajtimin e pengesave të mundshme të komunikuar nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, përmes:
  - a. hartimit të manualeve të dedikuara për këtë qëllim;
  - b. propozimin e masave për trajtimin e këtyre pengesave;
  - c. përcaktimit të afateve kohore për përmbushjen e tyre;
  - d. hartimit të planeve të kontigjencës që përfshijnë masat konkrete dhe afatet përkatëse për zbatimin e tyre ("Plani Operacional").
3. Në mënyrë të veçantë, ky program duhet të përfshijë masat për trajtimin e pengesave të mundshme të identifikuara nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Propozimet për trajtimin e këtyre pengesave duhet të jenë:
  - a. specifike, që do të thotë që masa trajton qartë pengesën e identifikuar;
  - b. të matshme, që do të thotë se zvogëlimi/eliminimi i parashikuar i pengesës mund t'i atribuohet qartë masës dhe të jetë e vlerësueshme;
  - c. të arritshme, që do të thotë se banka i dedikon burime të mjaftueshme zbatimit të masës;
  - d. të zbatueshme, që do të thotë se masa mund të zbatohet në mënyrë të besueshme brenda afatit kohor të propozuar.
4. Dy herë në vit, banka i komunikon Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme një "Raport mbi ecurinë e programit të punës mbi aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme" që miratohet nga këshilli drejtues. Ky raport dokumenton përparimin e bankës në drejtim të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, përshkruan mangësitë e identifikuara dhe propozon përparësitë e identifikuara për

<sup>6</sup> Shtuar me vendimin Nr.68 dt. 25.11.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë



ciklin e ardhshëm të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Raporti duhet të jetë mjaftueshëm i detajuar për t'i mundësuar Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme:

- a. vlerësimin e manualeve/planeve të kontigjencës së bankës dhe krahasimin e tyre me objektivat e përcaktuara nga Autoriteti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme;
  - b. përditësimin e vlerësimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në fund të çdo cikli të planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
5. Banka raporton çdo informacion shtesë të nevojshëm që i mundëson Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerësimin sipas shkronjës “a” dhe “b” të pikës 4, të këtij neni.

#### **Neni 27**

#### **<sup>7</sup>Komunikimi me bankat për pengesat thelbësore**

1. Nëse në përfundim të vlerësimit sipas këtij kreu, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vëren se ka pengesa thelbësore për kryerjen e procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme në një bankë, urdhëron marrjen e masave sipas nenit 15 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”.
2. Urdhëri sipas pikës 1 të këtij neni nxirret nga Autoriteti i përcaktuar me një akt të veçantë të Këshillit Mbikëqyrës.

### **KREU IV**

### **KËRKESAT PËR RAPORTIM**

#### **Neni 28**

#### **Kategoritë e informacionit për hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme**

1. Për hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme kërkon nga subjektet e kësaj rregulloreje çdo informacion të nevojshëm, në përputhje me pikën 5 të nenit 12 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”, i cili përmban, por nuk kufizohet, në informacionin e mëposhtëm:
  - a. **“Qeverisja dhe menaxhimi”** ku raportohet vendndodhja, juridiksioni, praktikat licencuese dhe të drejtimit për bankën dhe subjektet e grupit bankar.
  - b. **“Veprimtaritë kryesore”** ku raportohet:
    - i. identifikimi i veprimtarive kryesore, që përfshin aktivet dhe detyrimet për secilën veprimtari kryesore, për bankën dhe subjektet e grupit bankar, për ekspozimet brenda dhe jashtë bilancit.
    - ii. personat përgjegjës për raportimin e informacionit të nevojshëm për hartimin

---

<sup>7</sup> Shtohet me vendimin Nr.68 dt. 25.11.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë

e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankën si dhe (nëse janë të ndryshëm), për subjektet e tjera të grupit dhe veprimtaritë kryesore.

- c. **“Struktura e pasiveve”** ku raportohet:
- i. struktura e pasiveve të bankës dhe e të gjithë subjekteve përbërëse të grupit bankar, duke detajuar së paku detyrimet afatshkurtra dhe ato afatgjata, detyrimet e siguruara dhe ato të pasiguruara, si dhe borxhin e varur.
  - ii. identifikimi i detyrimeve që i përkasin instrumenteve të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar.
- d. **“Kolateralizimi”** ku identifikohen proceset e nevojshme për përcaktimin e palëve të treta ku banka ka vendosur kolaterale, mbajtësit e këtyre kolateraleve dhe juridiksioni i vendndodhjes së tyre.
- e. **“Sistemet e pagesave, klerimit dhe shlyerjeve”** ku raportohet:
- i. të gjithë sistemet, nëpërmjet të cilëve banka kryen një numër ose vlerë të konsiderueshme të operacioneve të saj të tregtimit, duke përfshirë lidhjet e bankës me personat juridikë, funksionet me rëndësi kritike dhe veprimtaritë kryesore.
  - ii. çdo sistem i pagesave, *klerimit* dhe shlyerjeve, në të cilët banka është anëtare e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, duke përfshirë lidhjet e bankës me personat juridikë, funksionet me rëndësi kritike dhe veprimtaritë kryesore.
- f. **“Sistemet e informacionit”** ku raportohet:
- i. inventari dhe përshkrimi i detajuar i sistemeve kryesore të administrimit të informacionit, të tillë si sistemi për administrimin e rreziqeve, kontabilitetin, financën dhe linjat e raportimit tek rregullatorët, përfshirë dhe shpërndarjen e tyre sipas personave juridikë, funksioneve me rëndësi kritike dhe veprimtarive kryesore;
  - ii. identifikimin e zotëruesve/pronarëve të sistemeve të lidhura me marrëveshjet përkatëse të shërbimit, të licencave, të programeve dhe sistemeve, përfshirë shpërndarjen e tyre ndërmjet personave juridikë, funksioneve me rëndësi kritike dhe veprimtarive kryesore.
- g. **“Ndërlidhjet”** ku raportohet mbi identifikimin dhe shpërndarjen e personave juridikë dhe të ndërlidhjeve dhe ndërvarësive ndërmjet tyre për:
- i. personelin e përbashkët, ndërtesat dhe sistemet,
  - ii. kapitalin, marrëveshjet për financim dhe likuiditetin,
  - iii. ekspozimet ekzistuese dhe ato të parashikuara të kredisë
  - iv. marrëveshjet e garancive të kryqëzuara, të kolateraleve të kryqëzuara, provigjionet e paaftësisë paguese të përbashkët dhe marrëveshjet e netimit mes filialeve;
  - v. transferimi i rrezikut dhe marrëveshjet e mbulimit tregtar (*back to back*);

marrëveshjet e shërbimeve.

- h. **“Marrëveshjet kontraktuale”** ku raportohet mbi të gjitha marrëveshjet e nënshkruara nga banka dhe subjektet e tjera juridike, ndërprerja e të cilave mund të nxitet nga një vendim i autoriteteve për të ndërmarrë veprimet e ndërhyjes së jashtëzakonshme si dhe ndikimin e ndërprerjes së marrëveshjes/ve në zbatimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
2. Për hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përdor dhe informacionin e mbledhur në formularët standardë të planeve të rimëkëmbjes sipas rregullores nr. 72, date 06.12.2017 “Për planet e rimëkëmbjes së bankave”, që përmban kategoritë e mëposhtme:
    - a. **“Struktura organizative”** ku raportohet:
      - i. një përshkrim i detajuar i strukturës organizative të bankës/grupit bankar, duke listuar të gjithë subjektet juridike;
      - ii. identifikimi i zotëruesve të drejtpërdrejtë dhe përqindja e të drejtës së votës për çdo subjekt të grupit bankar.
    - b. **“Funksionet me rëndësi kritike”** ku raportohet:
      - i. shpërndarja (*mapping*) e funksioneve me rëndësi kritike me veprimtaritë kryesore, që përfshin aktivet dhe pasivet për secilin funksion me rëndësi kritike, të çdo subjekti juridik, për ekspozimet brenda dhe jashtë bilancit.
      - ii. personat përgjegjës për raportimin e informacionit të nevojshëm për hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankën si dhe (nëse janë të ndryshëm), për subjektet e tjera të grupit dhe funksionet kritike.
    - c. **“Subjekte të rëndësishme”** ku raportohet identifikimi i subjekteve të rëndësishme si dhe analiza mbi ndikimin që sjell paaftësia paguese e tyre në pozicionin financiar të bankës.

## Neni 29

### Dispozitë e fundit

1. Për vitin 2018, bankat paraqesin informacionin e kërkuar në nenin 28 të kësaj rregulloreje jo më vonë se fundi i tremujorit të tretë të këtij viti.  
<sup>8</sup>Bankat paraqesin informacionin e kërkuar në nenin 28 të kësaj rregulloreje jo më vonë se fundi i muajit korrik të çdo viti.
2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme harton planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, brenda 4 viteve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

**KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS**  
**Gent SEJKO**

---

<sup>8</sup> Ndryshuar me vendimin Nr.68 dt. 25.11.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë

## ANEKS 1

### **Elementët që shqyrton Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vlerësimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në një bankë apo grup bankar.**

Kur vlerëson mundësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në një bankë apo grup bankar, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mban në konsideratë këto elemente:

- (1) aftësinë e bankës për shpërndarjen e veprimtarive kryesore dhe operacioneve me rëndësi kritike në personat juridikë;
- (2) shkallën e përputhshmërisë së strukturave ligjore dhe korporative me veprimtaritë kryesore dhe operacionet me rëndësi kritike;
- (3) ekzistencën e marrëveshjeve për të siguruar personel bazë, infrastrukturë, financim, likuiditet dhe kapital për mbështetjen dhe ruajtjen e veprimtarive kryesore dhe operacioneve me rëndësi kritike;
- (4) shkallën e zbatueshmërisë së kontratave të shërbimit të bankës, në rast të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në të;
- (5) shkallën e përshtatshmërisë së strukturës drejtuese të bankës për të menaxhuar dhe siguruar përputhshmëri me politikatat e brendshme të bankës në lidhje me kontratat e shërbimit;
- (6) aftësinë e bankës për të transferuar, në rast të ndarjes së funksioneve me rëndësi kritike ose të veprimtarive kryesore, shërbimet e ofruara nëpërmjet kontratave të shërbimit tek palët e treta;
- (7) aftësinë për të hartuar dhe parashikuar plane dhe masa që sigurojnë vazhdimësisë së sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes;
- (8) përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit të informacionit për të siguruar që Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mbledh informacion të saktë dhe të plotë mbi veprimtaritë kryesore dhe shërbimet me rëndësi kritike për të lehtësuar procesin e vendimmarrjes;
- (9) kapacitetin e sistemeve të menaxhimit të informacionit për të ofruar informacionin thelbësor të nevojshëm për realizimin efektiv të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës, në çdo kohë e madje edhe në kushte të ndryshueshme;
- (10) shkallën në të cilën banka ka testuar sistemet e saj të menaxhimit të informacionit në skenarë stresi, siç përcaktohet nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme;

(11) shkallën në të cilën banka mund të sigurojë vazhdimësinë e sistemeve të saj të menaxhimit të informacionit si për bankën e prekur ashtu edhe për institucionin e ri në rast se shërbimet me rëndësi kritike dhe veprimtaritë kryesore ndahen nga pjesa tjetër e shërbimeve dhe veprimtarive të bankës;

(12) përcaktimin nga ana e bankës të proceseve të përshtatshme për t'i ofruar Bankës së Shqipërisë informacionin e nevojshëm në lidhje me depozituesit dhe depozitat e siguruar nga skema e sigurimit të depozitave;

(13) në rastet e përdorimit të garancisë brenda grupit, shkallën me të cilën garancitë janë ofruar me kushtet e tregut dhe efikasiteti i sistemeve të menaxhimit të rrezikut lidhur me to;

(14) nëse grupi angazhohet në transaksione reciproke (*back to back*), kryerja e transaksioneve me vlerën e tregut dhe efikasiteti i sistemeve të menaxhimit të rrezikut lidhur me këto transaksione;

(15) shkallën me të cilën përdorimi i garancive brenda grupit ose kontabilizimi i transaksioneve reciproke rrit përhapjen e rrezikut të efektit zinxhir në të gjithë grupin;

(16) shkallën me të cilën struktura ligjore e grupit pengon zbatimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme si rezultat i numrit të personave juridikë, kompleksitetit të strukturës së grupit ose vështirësisë në vlerësimin e shpërndarjes së linjave të biznesit me subjektet e grupit;

(17) shumën dhe llojin e detyrimeve të pranuar të bankës;

(18) ekzistencën dhe qëndrueshmërinë e kontratave të shërbimit;

(19) nëse Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ka instrumentet e nevojshëm të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për mbështetjen e veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të autoriteteve të huaja dhe fushëveprim për të koordinuar veprimet me autoritetet e huaja;

(20) mundësinë e përdorimit të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në mënyrë të tillë që të përmbushen objektivat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke konsideruar instrumentet në dispozicion dhe strukturën e bankës;

(21) shkallën me të cilën struktura e grupit lejon Bankën e Shqipërisë të kryejë ndërhyrjen e jashtëzakonshme në një apo më shumë subjekte të grupit pa shkaktuar ndikim negativ të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në sistemin financiar, besimin e tregut ose në ekonomi, dhe me qëllim maksimizimin e vlerës së veprimtarisë bankare të grupit;

(22) masat dhe mjetet përmes të cilave mund të lehtësohet ndërhyrja e jashtëzakonshme, për grupet bankare që kanë filiale në juridiksione të ndryshme;

(23) besueshmërinë e përdorimit të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në mënyrë të tillë, që të përmbushen objektivat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke pasur parasysh ndikimet e mundshme tek kreditorët, kundërpalët, konsumatorët dhe punonjësit dhe veprimet e mundshme që mund të ndërmerren nga autoritetet përkatëse;

(24) shkallën në të cilën mund të vlerësohet në mënyrë të përshtatshme ndikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës në sistemin financiar dhe në besimin e tregut financiar;

(25) shkallën në të cilën ndërhyrja e jashtëzakonshme në bankë do të ndikonte negativisht, drejtpërdrejt apo tërthorazi, në sistemin financiar, besimin e tregut apo në ekonomi;

(26) mundësinë e frenimit të përhapjes së efektit zinxhir në banka të tjera apo në tregjet financiare, përmes zbatimit të instrumenteve dhe kompetencave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

(27) shkallën e ndikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në bankë në funksionimin e sistemeve të pagesave dhe shlyerjes.

## ANEKS 2<sup>9</sup>

### **Objektivat e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe parimet përkatëse.**

Kur identifikon pengesat e mundshme ndaj aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në bankë, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme (ANJ) merr në konsideratë përmbushjen e objektivave të mëposhtëm. Secili objektivi përmban parimet kryesore mbi pritshmërinë që ka ANJ në lidhje me hapat e nevojshme dhe nismat që banka duhet të ndërmarrë për të qenë e aftë për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

#### **Objektivi A. Qeverisja**

Banka ka një proces të qëndrueshëm drejtimi efektiv që mbështet përgatitjen dhe zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Ky drejtimi efektiv siguron: (i) ofrim të saktë dhe në kohë të informacionit të duhur për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, (ii) monitorim efektiv gjatë planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe në kohë krize, si dhe (iii) vendimmarrje efikase gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Në vlerësimin e përmbushjes së këtij objektivi, ANJ konsideron parimet e mëposhtme:

##### Parimi A.1- Përfshirja aktive e drejtuesve të bankës

Këshilli drejtues dhe Drejtoria ofrojnë të gjithë ndihmën e nevojshme për arritjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe operacionalizimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Këshilli drejtues përfshihet aktivisht në planifikimin për ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe identifikon një anëtar të keshillit dhe një anëtar të drejtorisë që drejton aktivitetin e bankës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

Për sa më lart:

1. Banka cakton një anëtar të keshillit drejtues përgjegjës për aktivitetin e bankës në drejtim të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe zbatimin e programit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme (i cili mund të mbështetet nga një komitet *ad hoc*).

Ky anëtar:

- a. është përgjegjësi përfundimtar për sigurimin e informacionit të nevojshëm për përgatitjen e planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe për personelin përgjegjës për funksionet kritike dhe veprimtaritë kryesore;
- b. është përgjegjës të sigurojë që banka përmbush detyrimet që ka ndaj ANJ-së për planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- c. siguron që planifikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme është i integruar në proceset e qeverisjes së përgjithshme të bankës;
- d. është përgjegjës për ndryshimin e komiteteve ekzistuese ose krijimin e komiteteve të reja, që mbështesin veprimtaritë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, kur është e nevojshme;

---

<sup>9</sup> Shtuar me vendimin Nr.68 dt. 25.11.2020 të Keshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë

- e. miraton raportimet në ANJ për ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe është përgjegjës për delegimin dhe kontrollin përkatës mbi sistemet e kontrollit të brendshme dhe mekanizmat që lidhen me ndërhyrjen e jashtëzakonshme;
  - f. informon rregullisht anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues mbi veprimtarinë e planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe aftësisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës, duke e dokumentuar përmes mbajtjes së procesverbaleve përkatëse;
  - g. kërkon dhe arsyeton mbi nevojat financiare (buxhetin e duhur) dhe personelin e nevojshëm për veprimtarinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
  - h. identifikon një drejtues të nivelit të lartë për koordinimin e aktiviteteve që lidhen me ndërhyrjen e jashtëzakonshme.
2. Banka emëron një drejtues të lartë/administrator të miratuar, me përvojë, i cili është përgjegjës për administrimin dhe koordinimin e programit të punës mbi planifikimin dhe aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme (i cili mund të mbështetet nga një grup ekspertësh).

Drejtuesi i lartë:

- a. koordinon dhe administron aktivitetet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme (p.sh. koordinimin në nivel teknik me ANJ, plotësimin e raportimeve, pyetësorëve dhe kërkesave të tjera të ANJ-së etj.);
- b. shërben me ekipin e tij si pika e centralizuar e kontaktit për ANJ-në për koordinimin, planifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- c. koordinon operacionalizimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme (përgatitjen dhe testimin e hapave përkatës për zbatimin e strategjisë së planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme) dhe merr pjesë në ushtrimet e simulimit që testojnë dhe vlerësojnë gatishmërinë operationale të bankës në drejtim të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- d. aty ku është e nevojshme, përcakton linja të dedikuara pune për personelin e nevojshëm që trajton çështjet që lidhen me ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

#### Parimi A.2- Drejtimi efektiv për ndërhyrjen e jashtëzakonshme

Proceset dhe format e organizimit dhe drejtimit efektiv të bankës sigurojnë që planifikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme të jetë i integruar në kuadrin e përgjithshëm të drejtimit efektiv të bankës dhe mbështet përgatitjen dhe zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Banka pritet të:

- a. sigurojë që funksioni i drejtimit për qëllimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme ka personelin e duhur që garanton se vendimet para, gjatë dhe pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme merren në kohën e duhur;
- b. përcaktojë qartë përgjegjësitë mbi raportimet dhe procedurat e përshkallëzimit të vendimmarrjes deri dhe përfshirjen e anëtarëve të këshillit drejtues si dhe procesin e miratimit për planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe zbatimin e tij (p.sh. zbatimi i vendimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, komunikimi me grupet përkatëse të interesit etj.). Këto procedura dokumentohen në manualët përkatëse të dedikuara për këtë qëllim;
- c. sigurojë se vendimet strategjike të bankës marrin në konsideratë ndikimin e ndërlikohjeve në aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme (p.sh. veprimtaritë që



- lidhen me përthithjen dhe blerjen, ristrukturimet e subjekteve juridike dhe ndryshimet në modelin e teknologjisë së informacionit (IT));
- d. informojë sa më shpejt ANJ-në për ndryshime të rëndësishme të tilla si, modeli i biznesit, struktura operationale (p.sh. ndryshimet në infrastrukturën IT) dhe qeverisja, të cilat ndikojnë planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, zbatimin e strategjisë së preferuar dhe aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme;
  - e. sigurojë se ka marrëveshje kontigjence që garantojnë se shërbimet e rëndësishme brenda grupit do të vijojnë të ofrohen dhe gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
  - f. sigurojë një rrjedhë efikase informacioni për çështjet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme midis Këshillit Drejtues, drejtorisë dhe personelit të rëndësishëm, duke bërë të mundur që ata të kryejnë rolet e tyre përkatëse para, gjatë dhe pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

#### Parimi A.3- Sigurimi i cilësisë dhe kontrolli i brendshëm

Banka ndërton procese të kontrollit të cilësisë për përmbushjen e kërkesave të ANJ-së dhe për raportimin e informacionit cilësor, të saktë dhe gjithëpërfshirës në kuadër të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Informacionet e rëndësishme të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, gjithashtu, rishikohen rregullisht nga kontrolli i brendshëm.

Banka pritet të:

- a. sigurojë informacion cilësor për ndërhyrjen e jashtëzakonshme;
- b. ketë procese që sigurojnë plotësinë dhe saktësinë e të dhënave;
- c. sigurojë se informacionet e rëndësishme dhe proceset për ndërhyrjen e jashtëzakonshme rishikohen rregullisht nga kontrolli i brendshëm (planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme janë pjesë e planit vjetor të kontrollit);

#### Parimi A.4-Testimi dhe operacionalizimi i strategjisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme

Banka përshkruan në manuale të dedikuara aspektet operationale të zbatimit të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme (përfshirë përgjegjësitë dhe procedurat e përshkallëzimit), dhe teston rregullisht zbatueshmërinë e këtyre manualeve përmes ushtrimeve të simulimit.

### **Objektivi B. Kapaciteti i përthithjes së humbjeve dhe rikapitalizimit**

Banka ka një nivel të mjaftueshëm burimesh financiare për përthithjen e humbjeve dhe, nëse është e zbatueshme, për rikapitalizimin e saj, që mundëson (i) mbulimin e të gjitha humbjeve në ndërhyrje të jashtëzakonshme, (ii) plotësimin e kushteve për vazhdimësinë e kryerjes së veprimtarive për të cilat banka është licencuar sipas ligjit për bankat (iii) ruajtjen e besimit të tregut pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe (iv) vijueshmërinë e funksioneve kritike gjatë dhe pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Në vlerësimin e përmbushjes së këtij objektivi, Autoriteti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme konsideron parimet e mëposhtme:

#### Parimi B.1 - Niveli i mjaftueshëm i përthithjes së humbjeve dhe aftësisë për rikapitalizim

Për përmbushjen e nivelit të mjaftueshëm të burimeve financiare për përthithjen e humbjeve dhe rikapitalizim<sup>10</sup>, banka identifikon dhe vlerëson:

- a. shumën e detyrimeve që sipas strategjisë së preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme kontribuon në përthithjen e humbjeve dhe/ose rikapitalizim;
- b. shumën e detyrimeve që përjashtohen detyrimisht nga ushtrimi i kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit sipas nenit 31, pika 2 e ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”;
- c. shumën e detyrimeve të cilat mund të përjashtohen nga ushtrimi i kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit, duke marrë parasysh të paktën faktorët e mëposhtëm:
  - i. maturimin;
  - ii. nënrenditjen;
  - iii. llojet e zotëruesve të instrumentit, ose transferueshmëria e instrumentit;
  - iv. pengesat ligjore ndaj përthithjes së humbjes siç është mungesa e njohjes së instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme sipas ligjit të huaj ose ekzistenca e të drejtave të përcaktuara;
  - v. faktorë të tjerë që krijojnë rrezik që detyrimet të përjashtohen nga përthithja e humbjeve në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

#### Parimi B.2 - Njohja ndërkufitare e veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Banka ka marrëveshje të përshtatshme që sigurojnë njohjen ndërkufitare dhe zbatimin efektiv të veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Për marrëveshjet e rregulluara nga ligjet e një vendi të tretë, banka pritet të përfshijë klauzola kontraktuale që janë efektive dhe të zbatueshme në vendin tjetër, të cilat:

- a. sigurojnë se zhvlerësimi dhe konvertimi i detyrimeve është efektiv dhe i zbatueshëm në atë shtet, në përputhje me nenin 42 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”. Për transaksionet e derivateve të ekzekutuara në bazë të një Marrëveshjeje Ndërkombëtare të Shoqatës së Këmbimeve dhe Derivateve (ISDA) (ose një marrëveshje tjetër të mbuluar nga protokollin), aderimi nga të gjitha palët në protokollin përkatës të ISDA për rikapitalizimin nga brenda, është një mënyrë e përshtatshme për të arritur këtë njohje kontraktuale;
- b. sigurojnë, sipas përcaktimit në nenin 51 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”, se zbatimi i masave të parashikuara në këtë ligj, nuk përbën shkak që pala të përfundojë, pezullojë, modifikojë, netojë ose të ekzekutojë çdo garanci të vendosur mbi pronat e bankës, duke përfshirë klauzolën që kontrata mund t’i nënshtrohet ushtrimit të kompetencave të pezullimit sipas neneve 52 deri në 54 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”.

#### Parimi B.3- Operacionalizimi i kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit

Banka krijon procedura të brendshme, struktura të brendshme dhe kapacitete në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit (SMI) që mbështesin ekzekutimin operacional të kompetencës së ANJ-së për zhvlerësim dhe konvertim, në terma të zbatimit të brendshëm në bankë dhe në terma të ndërveprimit me palët e treta, si dhe vlerëson e teston rregullisht efektivitetin e tyre. Banka ndërton proceset dhe infrastrukturën e nevojshme që i sigurojnë

---

<sup>10</sup>Neni 41, pika 1, ligji nr.133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”

ANJ-së, brenda një afati të shkurtër kohor, të dhëna të plota mbi aftësinë e përthithjes së humbjeve nga detyrimet<sup>11</sup>.

Për këtë qëllim, banka pritët të hartojë një “Manual për rikapitalizimin nga brenda”, i cili duhet të përshkruajë:

- a. të gjitha format e organizimit dhe të drejtimit efektiv, veprimet dhe proceset që duhet të ndërmerren në emër të bankës për zbatimin në mënyrë efektive të kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit;
- b. rendin e ngjarjeve sipas afateve kohore për hartimin dhe përshtatjen e skemës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ligjshmërinë, operacionalizimin, kontabilitetin dhe taksimin për secilin lloj instrumenti të përshtatshëm për ekzekutimin e rikapitalizimit nga brenda si dhe procedurat e qeverisjes që zbatohen për secilën fazë (njësitë që përgjegjëse dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse);
- c. marrëveshjet për ekzekutimin e jashtëm të kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit, përfshirë marrëveshjet e komunikimit me aktorët e jashtëm të rëndësishëm për zbatimin e kësaj kompetence (p.sh. depozitari qendror i titujve, autoritetet e tregjeve financiare etj.). Banka ndërton sisteme dhe burime që prodhojnë me shpejtësi (p.sh. brenda disa orësh), informacione të përditësuara në lidhje me: (i) letrat me vlerë që i nënshtrohen instrumentit të rikapitalizimit nga brenda, duke përfshirë zotëruesin dhe kodin përkatës identifikues të titullit; dhe (ii) depozitarin qendror të titujve ku janë emetuar dhe ruhen letrat me vlerë. Banka ndërton kapacitete për identifikimin e agjentëve që mundësojnë ekzekutimin në kohë të kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit, kur kjo bëhet e domosdoshme;
- d. proceset që sigurojnë se informacioni i dorëzuar ANJ-së për operacionalizimin e instrumentit të rikapitalizimit nga brenda është i plotë, i saktë dhe i nënshtrohet një procesi të kontrollit të cilësisë. “Manuali për rikapitalizimin nga brenda” dokumenton gatishmërinë e SMI-ve për sigurimin e informacionit të saktë, të plotë dhe në kohë, me qëllim zbatimin e instrumentit të rikapitalizimit nga brenda. Objektivi E përshkruan pritshmëritë në lidhje me menaxhimin e informacionit për këtë qëllim.
- e. marrëveshjet që trajtojnë çështjet ndërkufitare, të tilla si marrëveshjet kontraktuale të përmendura si më sipër.

“Manuali për rikapitalizimin nga brenda” miratohet nga drejtuesi ekzekutiv përgjegjës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme i identifikuar sipas Objektivit A.

#### Parimi B.4 - Niveli i mjaftueshëm i instrumenteve për kërkesën minimale për kapital rregullator dhe detyrime të pranuar.

Banka mban një nivel të mjaftueshëm instrumentesh që përmbushin kriteret për kërkesën minimale për kapital dhe detyrime të pranuar<sup>12</sup> të përcaktuara nga ANJ-ja në përputhje me strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës, modelin e biznesit, modelin e financimit, profilin e rrezikut dhe vlerësimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

Banka pritët të:

<sup>11</sup> Neni 45 pika 7, ligji nr.133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”

<sup>12</sup> Neni 32 pika 1, ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”

- a. sigurojë në kohën e duhur dhe me besueshmëri, të gjitha informacionet e nevojshme që i mundësojnë ANJ-së përcaktimin e kërkesës minimale për kapital dhe detyrime të pranuar, duke përfshirë rregullimet specifike në nivel banke për këtë kërkesë;
- b. përmbushë në mënyrë të vazhdueshme kërkesën minimale për kapital dhe detyrime të pranuar të komunikuar nga ANJ<sup>13</sup>.

Parimi B.5 - Cilësi e lartë e instrumenteve që përmbushin kriteret për kërkesën minimale për kapital dhe detyrime të pranuar

Banka mban detyrime të pranuar që mund të përdoren në mënyrë të besueshme për përthithjen e humbjeve dhe rikapitalizimin e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, duke përfshirë detyrimin për mbajtjen e instrumenteve të nënrenditura, sipas kërkesës së ANJ-së.

Në këtë drejtim, banka pritet të:

- a. sigurojë në çdo kohë të gjithë informacionin, përfshirë aty ku është e nevojshme, opinion të lëshuar nga një studio ligjore që arsyeton klasifikimin e instrumentit si i pranuar, sipas nenit 42, pika 4, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”;
- b. sigurojë që kërkesa për instrumente të nënrenditura të përmbushet me detyrime të pranuar të përshtatshme<sup>14</sup>;
- c. vendosë, kur është e zbatueshme, klauzolë për njohjen kontraktuale të rikapitalizimit nga brenda për detyrimet e pranuar të rregulluara nga ligji i një vendi tjetër;
- d. paraqesë çdo dokumentacion të opsionit *call*, shlyerjes, ripagimit ose riblerjes së instrumenteve të detyrimeve të pranuar, në përputhje me dispozitat rregullative të përcaktuara nga ANJ.

## **Objektivi C. Likuiditeti dhe financimi në ndërhyrje të jashtëzakonshme**

Banka krijon procese dhe kapacitete për (i) vlerësimin e nevojave për likuiditet dhe financim për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme<sup>15</sup>, (ii) matjen dhe raportimin e situatës së likuiditetit gjatë ndërhyrjes të jashtëzakonshme dhe (iii) identifikimin dhe transferimin e kolateralit që mund të përdoret për të marrë financim gjatë dhe pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Për vlerësimin e këtij objektivi, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme merr në konsideratë parimet e mëposhtme.

Parimi C.1 - Vlerësimi i likuiditetit dhe nevojës për financim në ndërhyrje të jashtëzakonshme

Banka krijon dhe zbaton metodologji të qëndrueshme për vlerësimin *ex-ante* të likuiditetit dhe nevojës për financim për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas supozimeve të ndryshme, dhe identifikon burimet e mundshme të likuiditetit që mbështesin ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

<sup>13</sup> Neni 6, shkronja “d” në këtë rregullore

<sup>14</sup> Neni 32 pika 3, ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”

<sup>15</sup> Neni 12 pika 5, shkronja “dh”, neni 13 pika 2, neni 15 dhe neni 15 pika 9 (për grupet bankare), ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”

Banka pritet të identifikojë faktorët kryesorë që ndikojnë likuiditetin në ndërhyrje të jashtëzakonshme. Në analizën e faktorëve të likuiditetit, banka merr në konsideratë kriza me natyrë të ndryshme (p.sh. një krizë të papritur likuiditeti ose një krizë që ka zhvillim të ngadaltë, një krizë të paaftësisë paguese të bankës ose një krizë të pastër likuiditeti etj.) dhe identifikon faktorët e rrezikut të likuiditetit që lidhen me to (p.sh. tërheqjet e depozitave, nevojat e likuiditetit për aksesin në tregjet financiare etj.).

Banka pritet të zhvillojë metodologji që simulojnë skenarë të ndryshëm të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në lidhje me flukset e parave që rrjedhin nga aktivet, detyrimet dhe zërat jashtë bilancit dhe ecurisë së kapacitetit kundërbalancues gjatë kohës së nevojshme<sup>16</sup>. Simulimet duhet të përfshijnë:

- a. flukset kontraktuale hyrëse dhe dalëse;
- b. sjelljet e flukseve hyrëse dhe dalëse;
- c. ecurinë e aftësisë balancuese dhe vlerën e likuiditetit të saj pas zbritjeve të supozuara (*haircut*).

Këto flukse monetare dhe aftësia kundërbalancuese do të simulohen:

- a. në nivelin e shumës totale të monedhës raportuese dhe të secilës monedhë të rëndësishme;
- b. për një periudhë të përshtatshme, që fillon nga brenda natës deri në një kohë të mjaftueshme (p.sh. gjashtë muaj) pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Kur banka vlerëson likuiditetin dhe nevojën për financim për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, një vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet:

- a. pengesave ligjore, rregullatore dhe operacionale për transferimin e likuiditetit, veçanërisht midis subjekteve të grupit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- b. detyrimeve që lidhen me shërbimet e pagesës, kleringut dhe shlyerjes, përfshirë efektet e mundshme në likuiditet që mund të sjellin veprimet e pafavorshme të ndërmarra nga Infrastruktura e Tregut Financiar;
- c. pezullimit, përfundimit dhe ndërprerjes kontraktuale të të drejtave që palët mund të ushtrojnë në ndërhyrjen e jashtëzakonshme;
- d. pengesave ligjore dhe operacionale për mobilizimin në kohën e duhur të kolateralit në dispozicion;
- e. nevojave specifike të likuiditetit brenda ditës në lidhje me elementet e përmendura më lart;
- f. instrumenteve të likuiditetit të ofruara nga Banka e Shqipërisë dhe kushtet përkatëse për përdorimin e tyre (p.sh. kolaterali, marzhet reduktuese (*haircuts*) dhe afatet kohore).

Banka pritet të arsyetojë në një dokument të veçantë mbi supozimet bazë të simulimit të likuiditetit (p.sh. marzhet reduktuese (*haircut*), normat e rinovimit (*rollover rates*), nivelet e rrjedhjes (*runoff rates*) etj.). Gjithashtu, banka merr në konsideratë rezultatit e analizës së mësipërme në strategjinë e rreziqeve të likuiditetit në ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe në planin përkatës të financimit. Kur është e rëndësishme, banka pritet të arsyetojë si mund të trajtojë pengesat potenciale, veçanërisht për aksesin në likuiditet sipas monedhave të rëndësishme.

#### Parimi C.2- Matja dhe raportimi i situatës së likuiditetit në ndërhyrje të jashtëzakonshme

<sup>16</sup> Sipas nenit 6, rregullores nr.27/2019 "Per raportin e mbulimit me likuiditet"

Banka krijon procese dhe kapacitete për matjen dhe raportimin e nevojës për likuiditet dhe financim në ndërhyrje të jashtëzakonshme, si dhe burimet e disponueshme të likuiditetit.

Banka pritet të jetë e aftë të masë dhe të raportojë pozicionin e likuiditetit brenda një afati të shkurtër kohor nga kërkesa e ANJ-së. Gjithashtu, banka pritet të jetë e aftë të parashikojë pozicionin e likuiditetit neto përgjatë periudhave kohore (edhe brenda ditës), duke raportuar:

- a. flukset hyrëse dhe dalëse të parave (të diferencuara sipas flukseve kontraktuale dhe të sjelljes);
- b. aftësinë kundërbalancuese dhe vlerën e likuiditetit të saj pas supozimeve të marzheve reduktuese (*haircut*).
- c. ndarjen sipas monedhave kryesore;
- d. supozimet përkatëse në lidhje me *stress test*-et e likuiditetit.

### Parimi C.3 - Identifikimi dhe mobilizimi i kolateralit gjatë dhe pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Banka krijon procese dhe zhvillon aftësi për identifikimin dhe mobilizimin e aktiveve që mund të përdoren si kolateral për financim gjatë dhe pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Gjithashtu, banka identifikon kohën e nevojshme për mobilizimin e këtij kolaterali dhe hapat e nevojshme për ta bërë atë të pranueshëm për palët e treta.

Për këtë qëllim, banka pritet të:

- a. identifikojë kolateralin në dispozicion dhe të :
  - i. përcaktojë të gjitha aktivet që mund të kualifikohen potencialisht si kolateral dhe përmbushin kriteret për financimin në ndërhyrje të jashtëzakonshme (Aktivet e nivelit 1, aktivet e nivelit 2A, si dhe aktivet e nivelit 2B)<sup>17</sup>
  - ii. të diferencojë aktivet e barrësuara dhe të pabarrësuara dhe të përcaktojë të drejtat ligjore për të gjithë kolateralin (të barrësuar ose jo);
  - iii. monitorojë kolateralin e pabarrësuar ose të disponueshëm për secilën monedhë të rëndësishme;
  - iv. zhvillojë aftësinë për raportim të detajuar, edhe në kushte ndryshimesh të shpejta, të kolateralit në disponueshëm (p.sh. përshtatshmërinë e tij për operacionet e bankës qendrore, monedhën, llojin e aktiveve, vendndodhjen, cilësinë e kredisë etj.);
- b. operacionalizojë mobilizimin e kolateralit, duke u përqendruar në mënyrë të veçantë në aktivet më pak të tregtueshme;
- c. vlerësojë mobilizimin e kolateralit dhe të paktën, çdo vit, të vlerësojë procedurat operacionale dhe efektivitetin e mobilizimit të kolateralit të disponueshëm (p.sh. aftësinë për ta shitur, për të marrë pjesë në operacionet e riblerjes ose për të huazuar kundrejt këtij kolaterali).

## **Objektivi D. Vazhdimësia operacionale**

<sup>17</sup>Sipas nenet 11 deri 14 të rregullores nr.27/2019 “Per raportin e mbulimit me likuiditet”

Banka harton marrëveshje operacionale që sigurojnë vazhdimësinë e shërbimeve të nevojshme për ruajtjen e funksioneve kritike dhe veprimtarive kryesore, të nevojshme për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes dhe çdo ristrukturim të mëtejshëm të aktivitetit.<sup>18</sup>

Për këtë qëllim, banka duhet të krijojë procedura operacionale që mundësojnë vazhdimësinë e të gjitha shërbimeve që mbështesin:

- a. funksionet kritike për ekonominë dhe tregjet financiare (shërbime kritike);
- b. veprimtaritë kryesore që janë të rëndësishme për zbatimin efektiv të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe ristrukturimin e aktivitetit që e pason atë.

Të gjitha këto shërbime referohen në vijim si shërbime të lidhura kritike.

Në vlerësimin e këtij objekti, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme merr në konsideratë parimet e mëposhtme:

Parimi D.1- Identifikimi dhe shpërndarja e ndërlidhjeve për vazhdimësinë operacionale

Banka identifikon të gjitha shërbimet e lidhura, aktivet dhe personelin operacional, të domosdoshëm për vazhdimësinë e funksioneve kritike dhe veprimtarive kryesore dhe për zbatimin efektiv të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe ristrukturimit që e pason atë, dhe duke i shpërndarë ato sipas subjekteve juridike, funksioneve kritike, veprimtarive kryesore dhe marrëveshjeve kontraktuale.

Banka pritet të:

- a. identifikojë shërbimet e lidhura kritike (të ofruara brenda grupit ose nga palë të treta), aktivet dhe personelin operacional. Shërbimet e lidhura nuk konsiderohen si kritike kur (i) ndërprerja e tyre nuk ka ndonjë ndikim të rëndësishëm në aftësinë e bankës për kryerjen e funksioneve kritike dhe veprimtarive kryesore ose (ii) ato mund të ofrohen nga një ofrues tjetër brenda një afati kohor të arsyeshëm në terma të njëjtë për sa i takon objektivit, cilësisë dhe kostos;
- b. shpërndajë shërbimet e lidhura kritike sipas funksioneve kritike, veprimtarive kryesore dhe subjekteve juridike (që e ofrojnë dhe marrin shërbimin), si dhe aktivet dhe personelin operacional kritik dhe vendndodhjen e tyre (brenda grupit dhe fizikisht). Këto ndërlidhje duhet të përfshijnë sipas rastit, edhe shërbimet e ofruara nga subjekte të ndryshme (p.sh. një ofrues i shërbimit brenda grupit që nënkontraktin një palë të tretë);
- c. shpërndajë shërbimet e lidhura kritike sipas kontratave/marrëveshjeve që ka lidhur për to
- d. zhvillojë dhe të ruajë një bazë të dhënash të kërkueshme (katalog shërbimi) ku mblidhen të gjithë informacionet e mësipërme të hartuara nga banka, që mund të aksesohen në mënyrë të besueshme, edhe në situata stresi, për planifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Gjithashtu, banka pritet të garantojë se:

- a. marrëveshjet kontraktuale, me palët e treta dhe me ofruesit e shërbimit brenda grupit, janë të dokumentuara mirë dhe përfshijnë të gjithë informacionin që i

---

<sup>18</sup> Neni 20, pika 2, ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”

mundëson ANJ-së të marrë veprimet e duhura dhe të zbatojë kompetencat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi to (p.sh., transferimin e ofrimit të shërbimeve);

- b. marrëveshjet për shërbimet e brendshme në bankë kanë të dokumentuar informacionin që lehtëson identifikimin dhe hartimin e shpejtë të marrëveshjeve transitore, në rast se kërkohet sipas strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

#### Parimi D.2 - Vlerësimi i rrezikut të vazhdimësisë operacionale

Banka vlerëson në mënyrë gjithëpërfshirëse rrezikun për vazhdimësinë operacionale në ndërhyrje të jashtëzakonshme, të tillë si ndërprerja e shërbimeve të rëndësishme, humbja e aksesit në aktivet operative përkatëse dhe mungesa e personelit përkatës.

Përmes identifikimit dhe shpërndarjes së shërbimeve kritike, aktiveve dhe personelit përkatës operacionale, banka pritët të vlerësojë rrezikun e ndërprerjes së tyre në ndërhyrje të jashtëzakonshme, dhe të identifikojë veprimet lehtësuese që duhet të ndërmerret (Objektivi C). Banka pritët të kryejë një analizë gjithëpërfshirëse të rrezikut të vazhdimësisë operacionale bazuar në identifikimin paraprak të ngjarjeve potenciale (faktorëve të riskut)<sup>19</sup> që mund të shkaktojnë ndërprerje të këtyre shërbimeve.

Analiza e rrezikut të vazhdimësisë operacionale merr në konsideratë elemente të tilla si:

- a. kuadri ligjor i zbatueshëm për kontratat e shërbimeve kritike;
- b. vendndodhja dhe statusi juridik i aktiveve operacionale (në zotërim ose me qera);
- c. mundësia e mungesës së personelit të rëndësishëm në ndërhyrje të jashtëzakonshme, duke përfshirë rastet kur personeli i rëndësishëm është i punësuar nga një subjekt i grupit që mund të shkojë në likuidim të detyruar ose që mund të shitet në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

Si pjesë e analizës së rrezikut, banka pritët të vlerësojë se (i) kontratat operacionale janë të dokumentuara mirë, (ii) struktura e kostos dhe çmimeve të tyre është transparente dhe e përcaktuar në bazë të arsyeshme (*arm length basis*) dhe (iii) ofruesit e shërbimeve kanë burime financiare të mjaftueshme për të ofruar shërbimet kritike gjatë dhe pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme (Objektivi C).

#### Parimi D.3-Veprimet për zbutjen e rreziqeve për vazhdimësinë operacionale dhe përmirësimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme

Banka zbaton veprimet e duhura për zbutjen e rreziqeve të identifikuara për vazhdimësinë operacionale në ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe merr masa për përmirësimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe ristrukturimin që e pason.

Banka pritët të identifikojë dhe të ndërmerret veprime që zbusin rreziqet e vazhdimësisë operacionale të identifikuara. Gjithashtu, pritët që banka të garantojë se kontratat operacionale për shërbimet e ofruara brenda grupit ose nga palët e treta kanë klauzolë mbrojtëse ndaj ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Mbrojtja e kontratës nga ndërhyrja e jashtëzakonshme mund të arrihet përmes klauzolave eksplicite për këtë qëllim. Kjo do të

---

<sup>19</sup> Faktorë e riskut janë, ato ngjarje të mundshme që mund të çojnë në materializimin e rreziqeve të vazhdimësisë operacionale në ndërhyrje të jashtëzakonshme (p.sh. përfundimi i njëanshëm i shërbimeve kritike nga ofruesi kur banka vihet në ndërhyrje të jashtëzakonshme).



thotë se për sa kohë që banka ka kryer pagesat thelbësore për këto kontrata, klauzola garanton:

- a. mosndërprerjen, pezullimin ose modifikimin e ofrimit të shërbimit për shkak të ndërhyrjes së jashtëzakonshme/ristrukturimit të bankës;
- b. tranferueshmërinë e ofrimit të shërbimeve të marrësi i ri ose të ANJ-ja për shkak të ndërhyrjes së jashtëzakonshme/ristrukturimit të bankës;
- c. mbështetjen e transferimeve të iniciuara ose të pezulluara gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme/ristrukturimit të bankës.

Në rast se banka nuk është në gjendje të garantojë kontrata të mbrojtura nga ndërhyrja e jashtëzakonshme, pritet që të arsyetojë në detaje pse nuk mund të amendohet kontrata dhe të paraqesë strategji potenciale alternative, (p.sh. duke kaluar te ofrues të tjerë që mundësojnë përfshirjen e kësaj klauzole). P.sh., në rast se kuadri ligjor i zbatueshëm për një kontratë të pambrojtur nga ndërhyrja e jashtëzakonshme me një palë të tretë është jashtë juridiksionit të ANJ-së, banka pritet të ruajë burime të mjaftueshme likuiditeti për të parafinancuar koston e kontratës për shërbimin, për një periudhë të caktuar kohe (minimumi 6 muaj) nga zbatimi i një mase sipas ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka” në bankë.

Banka pritet të ketë procese të qarta të vlerësimit të kostos dhe çmimit për shërbimet e lidhura kritike që përdor, me qëllim që ato të jenë transparente, të parashikueshme dhe të përcaktuara në bazë të arsyeshme tregu (*arm's length*). Këto procese duhet të ofrojnë siguri *ex-ante* mbi kostot e shërbimeve të lidhura kritike që ato të mund të ofrohen edhe në ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe të lehtësojnë vendimmarrjen përkatëse gjatë fazës së ristrukturimit që e pason.

Gjithashtu, banka pritet të ketë procese të planeve të kontigjencës që sigurojnë se njësitë kryesore të biznesit që mbështesin shërbimet e lidhura kritike, kanë personelin e duhur në ndërhyrje të jashtëzakonshme. Këto procese përfshijnë:

- a. plane të mbajtjes së personelit përkatës në punë (si dhe qeverisjen dhe proceset përkatëse) që detajojnë masat që banka mund të marrë brenda një afati të shkurtër kohor, përpara ose gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme, për zbutjen e rrezikut të dorëheqjes së personelit të nevojshëm për shërbimet e lidhura kritike;
- b. plane kontigjence që trajtojnë humbjen e personelit përkatës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, si p.sh. të sigurojë se personeli alternativ me aftësi dhe njohuri të përshtatshme mund të zëvendësojë pozicionet relevante të punës;
- c. procese që trajtojnë rrezikun që lidhet me personelin që ndodhet në pozicione të dyfishta të punës gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme<sup>20</sup>.

Për sa më lart, banka merr në konsideratë kuadrin ligjor të kodit të punës si dhe kërkesat rregullatore në lidhje me miratimin e nevojshëm për ndryshime në përgjegjësitë e personelit dhe të pagës përkatëse.

## **Objektivi E. Aksesi në Infrastrukturën e Tregjeve Financiare (ITF)**

---

<sup>20</sup> Psh. një marrëveshje që u lejon subjekteve të aksesojnë funksionet e ofruara nga personel i cili është i përkohshëm.

Banka ndërton proceset dhe marrëveshjet e nevojshme që sigurojnë ruajtjen e aksesit në shërbimet e Infrastrukturës së Tregjeve Financiare dhe në ato të pagesës, klerimit, shlyerjes dhe kujdestarisë të ofruara nga ndërmjetësit ITF përpara, gjatë dhe pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Në vlerësimin e këtij objekti, ANJ-ja merr në konsideratë parimet e mëposhtme.

#### Parimi E.1-Identifikimi, shpërndarja dhe vlerësimi i varësisë nga ofruesit e shërbimeve ITF

Banka identifikon të gjithë ofruesit e shërbimeve kritike ITF si dhe ndërmjetësit përkatës dhe i shpërndan ata sipas subjekteve juridike, funksioneve kritike dhe veprimtarive kryesore.

Banka pritët të:

- a. identifikojë të gjithë ofruesit e shërbimeve të ITF të tillë si sistemet e pagesave dhe shlyerjeve, palët qendrore si dhe ndërmjetësit përkatës të këtyre tregjeve, të tillë si banka korrespondente ose banka që ofrojnë shërbime kujdestarie;
- b. identifikojë se cila nga shërbimet e lidhura ITF janë të nevojshme për vijueshmërinë e funksioneve kritike (shërbimet ITF kritike) dhe të veprimtarive kryesore (“shërbime bazike ITF”). Për këtë qëllim, banka pritët të bëjë një vlerësim objektiv duke marrë në konsideratë ndër të tjera, ndikimin e mundshëm të ndërprerjes ose të kufizimit të aksesit në to<sup>21</sup>:
  - i. në funksionet kritike dhe veprimtaritë kryesore të biznesit;
  - ii. për aq sa është e mundur, në aktivitetin e klientëve kryesorë, për palët e treta që shërbejnë si ndërmjetës për ofrimin e shërbimeve ITF në treg.
- c. shpërndajë shërbimet kritike dhe shërbimet bazë sipas subjekteve juridike të grupit dhe sipas funksioneve kritike përkatëse dhe veprimtarive kryesore të biznesit;
- d. identifikojë rolet kryesore që kryen në lidhje me ITF.

Banka pritët ta përfshijë këtë informacion në planin përkatës të kontigjencës për ITF-në sipas Objektivit D.

#### Parimi E.2-Njohja e kërkesave për akses të vazhdueshëm në ITF

Banka (i) ka kuptim të qartë të kushteve për akses të vazhdueshëm në shërbimet kritike dhe ato bazë të ITF-së<sup>22</sup> dhe (ii) dokumenton dhe vlerëson kërkesat operacionale dhe financiare që ITF dhe ndërmjetësit përkatës mund të vendosin para ose gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Banka pritët të:

<sup>21</sup> Psh në rast se ITF ose ndërmjetësi ITF nuk pranon tregtime të reja nga banka (ndërkohë që vijon t'i shërbejë tregtimeve të mëparshme),

<sup>22</sup> Neni 51, pikat 1 dhe 3, ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”

- a. ketë një kuptim të qartë të kushteve për akses të vazhdueshëm të shërbimeve bazë të ITF-së. Banka pritët të identifikojë dhe dokumentojë pengesat e rëndësishme, në veçanti pengesat financiare dhe operacionale, sipas kërkesave kontraktuale të ITF-së dhe ndërmjetësve përkatës si dhe të konsiderojë, se cilat detyrime mund të përbëjnë vështirësi për t'u përmbushur nga subjekti pasues i bankës në fazën pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme<sup>23</sup>. Gjithashtu, banka pritët të identifikojë pengesat kryesore kontraktuale me ndërmjetësit e tjerë që janë të rëndësishëm për të përdorur shërbimet e ITF-së<sup>24</sup>;
- b. konsiderojë veprimet që mund të ndërmarrin ITF dhe ndërmjetësit përkatës si p.sh. rritje e marzhit të kërkuar ose ulje e linjës së kreditit, si dhe kushtet dhe afatet kohore në të cilat mund të ndërmerren këto veprime (p.sh. brenda ditës ose brenda një numri të caktuar ditësh);
- c. përcaktojë kërkesat për likuiditet sipas skenarëve të ndryshëm të stresit financiar si dhe të ofrojë një vlerësim të arsyeshëm për këtë qëllim në raportimin e formularëve standardë për ITF-në, së bashku me të dhënat e nevojshme mbi linjat e kreditit, përdorimin e tyre si dhe nivelet historike mbi nevojën maksimale për likuiditet ose për përdorimin e kolateralit brenda një afati të caktuar kohor<sup>25</sup>;
- d. shpjegojë në planin e kontigjencës për ITF metodologjinë për vlerësimin e nevojës për likuiditet në rast stresi financiar, duke përfshirë supozimet që lidhen me vëllimin e pritshëm të aktivitetit të biznesit. Banka pritët të përfshijë dhe informacion shtesë mbi kërkesat potenciale (të tilla si komisione) që mund të vendosin ofruesit e shërbimeve të tjera të nevojshme për akses në ITF, në rast nevoje.

### Parimi E.3- Plani i kontigjencës për ITF dhe masat që sigurojnë akses të vazhdueshëm në shërbimet ITF

Banka ndërton plane kontigjence që përfshijnë masat që ka ndërmarrë për mbështetjen e aksesit të vazhdueshëm në shërbimet ITF, transferim të rregullt ose mbyllje të tyre, në rast nevoje<sup>26</sup>. Kjo përfshin (i) masat për maksimizimin e mundësisë që banka do të vijojë të përmbushë detyrimet për akses të vazhdueshëm në shërbimet ITF, përpara dhe gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme si dhe (ii) masa të tjera për mbështetjen e veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Banka pritët të zhvillojë një plan kontigjence për ITF që mbështet aksesin e vazhdueshëm në shërbimet ITF. Plani i kontigjencës ITF është një manual operacional, i miratuar nga niveli i lartë drejtues, i cili detajon ndër të tjera, për secilin nga shërbimet ITF dhe ndërmjetësit përkatës:

<sup>23</sup> Psh si rezultat i vështirësisë së bankës në mobilizimin e shpejtë të likuiditetit.

<sup>24</sup> Të tilla si ofruesit e shërbimeve të komunikimit (psh SWIFT), agjentët NOSTRO (për të siguruar akses të vazhdueshëm të shërbimet e pagesës në valutë (*Continuous Linked Settlement* , CLS), ose në shërbimet e ofruesve të IT (psh në përdorimin e një *software*-i të caktuar për të aksesuar IFT).

<sup>25</sup> Nevoja për likuiditet që lidhen me pjesëmarrjen e bankës në ITF duhet të marrin në konsideratë vlerësimin e nevojave totale për likuiditet të banëks përpara dhe gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

<sup>26</sup> Pika 7, Aneksi 1 në këtë rregullore.

- a. masat që trajtojnë veprimet që priten të ndërmarrin ofruesit e ITF-së përpara dhe gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- b. infrastrukturën, strukturat dhe proceset operationale që ka krijuar banka për të garantuar përmbushjen e detyrimeve thelbësore që mundësojnë aksesin në ITF dhe ndërmjetësit përkatës, të paktën për shërbimet kritike ITF. Kjo përfshin një identifikim të plotë të sistemeve kryesore dhe të personelit, të nevojshme për ruajtjen e aksesit në shërbimet ITF si dhe të procedurave që garantojnë se këto shërbime mund të aksesohen ose të zëvendësohen në kohë krize;
- c. masat që mund të ndërmarrë banka për zbutjen e rrezikut që lidhet me ndërprerjen ose kufizimin e aksesit në shërbimet ITF, psh nëpërmjet menaxhimit aktiv të ekspozimeve, parafinancim të detyrimeve ose procedurave alternative të besueshme të krijuara *ex-ante*. Për bankën për të cilën parashikohet likuidimi i një pjesë të aktivitetit, ky plan kontigjence duhet të marrë në konsideratë elementet përkatëse të këtij plani.

Në këtë drejtim, banka pritet të:

- a. përfshijë klauzolën përkatëse për mbrojtjen kontraktuale, në rast se banka vlerëson se kontratat me ndërmjetësuesit ose me ofruesit e tjerë të shërbimeve të domosdoshme për ruajtjen e aksesit me tregjet financiare nuk janë të mbrojtura ndaj ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- b. identifikojë zëvendësuesit potencialë të ofruesve të shërbimeve ITF si dhe kuadrin ligjor përkatës. Ky identifikim është i rëndësishëm për fazën e ristrukturimit që pason ndërhyrjen e jashtëzakonshme përmes p.sh., racionalizimit të pjesëmarrjes ose të anëtarësimit në ITF. Si zëvendësues potencialë të besueshëm mund të konsiderohen vetëm ofruesit alternativë të shërbimit, të cilët kanë një marrëdhënie kontraktuale me bankën;
- c. identifikojë kërkesat që duhet të plotësohen për transferueshmërinë e klientëve sipas shërbimeve kritike, proceseve dhe procedurave të ITF. Kjo nënkupton:
  - i. dhënien e informacionit të mjaftueshëm në lidhje me transferueshmërinë e klientëve për çdo kundërparti qendrore dhe për çdo segment ku banka vepron si agjent shlyerjeje (sipas raportimit që bën në formularin standard të ITF-së);
  - ii. të garantojë burimet dhe sistemet që duhet të ruhen përmes përditësimit të vazhdueshëm të informacionit, që duhet të ofrohet në mënyrë të shpejtë gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme për të siguruar se pozicioni i klientit në kundërpartitë qendrore si dhe aktivet e klientit në Sistemet Qendrore Depozitare (CDS), mund të transferohen në mënyrë të rregullt, duke përfshirë listën e klientëve për çdo llogari *omnibus*, pozicionin e klientëve, marzhet dhe aktivet e marra si kolateral për çdo klient, si dhe aktivet individuale të klientëve të mbajtura në Sistemet Qendrore Depozitare (CDS).

## **Objektivi F. Sistemet e informacionit dhe të prodhimit të të dhënave**

Banka ndërton Sisteme Menaxhimi Informacioni (SMI), kapacitete për vlerësimin për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme si dhe infrastrukturë teknologjike të përshtatshme, që siguron informacionin e nevojshëm për (i) zhvillimin dhe mirëmbajtjen e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme<sup>27</sup>, (ii) kryerjen e një vlerësimi të drejtë, të kujdesshëm dhe realist<sup>28</sup>, si dhe (iii) zbatimin efektiv të veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme<sup>29</sup> edhe nën kushte ndryshimesh të shpejta.<sup>30</sup>

Në vlerësimin e këtij objekti, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme merr në konsideratë parimet e mëposhtme:

Parimi F.1-Kapacitetet SMI për prodhimin e informacionit për përgatitjen dhe përditësimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Banka krijon kapacitete SMI që mundësojnë prodhimin e informacionit të nevojshëm për planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si në vijim:

- a. raportim të saktë dhe të detajuar të formularëve standardë të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme si pjesë e planifikimit vjetor të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- b. informacion gjatë kryerjes së ushtrimeve të simulimit.

Banka, gjithashtu, pritët të përshkruajë proceset e vendosura që garantojnë se informacioni i kërkuar për hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme përditësohet dhe është në dispozicion të ANJ-së në çdo kohë<sup>31</sup>. Për këtë qëllim banka pritët të ketë një databazë SMI të dhënash gjithëpërfshirëse që përmban informacionin e përditësuar sipas frekuencës së nevojshme për zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe ristrukturimin që e pason. Kjo databazë përfshin veçanërisht katalogun e shërbimeve të raportuar në Objektivin E dhe dokumentimin e kontratave të shërbimeve kritike në një format që mundëson kërkimin e informacionit të detajuar mbi to.

Në lidhje me kapacitetet SMI për funksionet kritike dhe shërbimet kritike, banka pritët të demonstrojë aftësinë për të prodhuar në kohë dhe në formë të përditësuar informacion mbi:

- a. përdorimin e shërbimeve dhe funksioneve kritike në kohë reale, monitorimin dhe raportimin e metrikave kryesore të të dhënave, sipas përcaktimit të ANJ-së<sup>32</sup>;
- b. llojet e kolateralit të pranuar nga secilin shërbim ITF;
- c. aktivet e përdorura për kolateral për secilin shërbim ITF;
- d. detyrimet kryesore për shlyerjen dhe dorëzimin në të ardhmen sipas vlerës dhe llojit të aktivit, përfshirë detyrimet kritike kohore.

Banka pritët të demonstrojë aftësinë që të:

- a. parashikojë dhe menaxhojë kërkesat e likuiditetit dhe të kolateralit për pjesëmarrjen e vazhdueshme në ITF, si pjesë e nevojave totale për likuiditet (Objektivi C);

<sup>27</sup> Neni 12, pika 5, ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”

<sup>28</sup> Neni 17, pika 1, shkronja ‘dh’, neni 24, ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”

<sup>29</sup> Neni 47, pika 1, ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”

<sup>30</sup> Neni 17, ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”

<sup>31</sup> Neni 12, pika 5 ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”

<sup>32</sup> Pikat 8, 9 dhe 27 te Aneksi 1 në këtë rregullore

- b. monitorojë likuiditetin dhe kolateralin e disponueshëm në secilin ofrues të shërbimit ITF në kohë reale;
- c. mobilizojë dhe transferojë kolateralet në vendndodhjen përkatëse dhe sipas monedhës përkatëse.

Parimi F.2- Kapacitetet SMI për prodhimin e informacionit për kryerjen e një vlerësimi të drejtë, të kujdesshëm dhe realist

Banka duhet të ketë kapacitete SMI që mundësojnë prodhimin e informacionit sa më të përditësuar dhe gjithëpërfshirës<sup>33</sup>, për kryerjen e një vlerësim të drejtë, të kujdesshëm dhe realist<sup>34</sup>.

Banka pritet të:

- a. vetvlerësojë disponueshmërinë e të dhënave dhe kapacitetin e grumbullimit të të dhënave gjatë fazës së planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në lidhje me procesin e vlerësimit për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme<sup>35</sup>;
- b. kryejë simulime që testojnë kapacitetin e bankës për të raportuar brenda një afati kohor të përcaktuar nga ANJ-ja (sipas komunikimit me bankën), të të gjithë ose të një pjese të të dhënave përkatëse për vlerësimin për ndërhyrje të jashtëzakonshme;
- c. shpjegojë dhe arsyetojë qartë burimet bazë të të dhënave, supozimet dhe metodologjitë e secilit prej modeleve të vlerësimit të brendshëm.

Parimi F.3-Kapacitetet SMI për prodhimin e informacionit për zbatimin efektiv të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Banka duhet të ketë kapacitete SMI që prodhojnë informacionin e nevojshëm për zbatimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në çdo kohë, madje edhe në raste ndryshimesh të shpejta<sup>36</sup>.

Banka pritet të demonstrojë sa më poshtë:

- a. kapacitete për të (i) vlerësuar nivelin e përthithjes së humbjeve<sup>37</sup> dhe (ii) prodhuar informacionin e nevojshëm për zbatimin e instrumentit të rikapitalizimit nga brenda, duke marrë në konsideratë dispozitat ligjore. Në këtë aspekt, banka pritet të krijojë:
  - i. një bazë të dhënash që përfshin një listë të informacionit minimal për secilin instrument të kapitalit dhe çdo titull tjetër të emtuar;
  - ii. procese për ruajtjen dhe përditësimin e këtij informacioni;
  - iii. analiza vlerësimi dhe arsyetimi për klasifikimin e titujve në “Kërkesën minimale për instrumente të kapitalit dhe detyrimeve të pranuar”.
- b. mirëmbajtjen e regjistrimeve të hollësishme të kontratave financiare;
- c. kur strategjia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përfshin instrumente të transferimit, për të gjitha aktivet dhe detyrimet e identifikuar për t'u transferuar (i) aftësinë për

<sup>33</sup> Neni 33, ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”

<sup>34</sup> Neni 17 pika 1, shkronja “dh”, neni 24, ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”

<sup>35</sup> Rregullore nr.44/2019 “Vlerësimi për qëllimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”.

<sup>36</sup> Pika 9, Aneksi 1 në këtë rregullore

<sup>37</sup> Sipas objektivit A dhe D

të siguruar informacion të disponueshëm të nevojshëm për vlerësimet përkatëse dhe (ii) aftësinë për t'i dhënë palëve të përfshira në transferim, akses të lehtë dhe të shpejtë në të dhënat e nevojshme p.sh. përmes krijimit dhe popullimit të një dhome të të dhënave virtuale (VDR) në kuadër të procesit *due diligence*;

- d. kapacitet për të prodhuar njëkohësisht të dhëna të shumta, për shembull në lidhje me menaxhimin e likuiditetit (shiko Objektivin C) dhe vlerësimin, nën presionin e kohës ose kushtet e stresit financiar, sipas përcaktimeve të ANJ-së.

## **Objektivi G. Komunikimi**

Banka harton plane komunikimi që sigurojnë një komunikim të shpejtë dhe të qëndrueshëm me palët e interesuara, në mbështetje të zbatimit të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Gjithashtu, banka ndërton procese të qeverisjes që sigurojnë zbatimin efektiv të planeve të komunikimit.

Për këtë qëllim banka pritët të përmbushë parimet e mëposhtme

### Parimi G.1- Plani i komunikimit

Banka harton një plan komunikimi gjithëpërfshirës për informimin e grupeve përkatëse të interesit në lidhje me ndërhyrjen e jashtëzakonshme, me qëllim kufizimin e efektit zinxhir dhe shmangien e pasigurisë në treg.

Më saktësisht, banka pritët të:

- a. identifikojë grupet e brendshme dhe të jashtme të interesit, të cilët duhet të informohen para, gjatë dhe pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme, përfshirë grupet e interesit të përcaktuara në nenin 14 të kësaj rregulloreje si dhe ofruesit përkatës të shërbimeve ose aktiveve operationale;
- b. përgatisë një listë të përditësuar të grupeve kritike të brendshme dhe të jashtme të interesit dhe t'ia komunikojë ANJ-së;
- c. hartojë një strategji komunikimi të targetuar sipas grupeve të interesit të identifikuar, me mesazhe të paracaktuara të përshtatura sipas strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme të komunikuar nga ANJ-ja, duke marrë në konsideratë ruajtjen e konfidencialitetit<sup>38</sup>. Për secilin grup interesi të identifikuar, plani i komunikimit:
  - i. formulon mesazhe të forta, konsistente dhe lehtësisht të kuptueshme;
  - ii. përmban mesazhet kryesore të komunikimit (dhe nivelin përkatës të detajimit) për të promovuar besimin në bankë gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përfshirë ndër të tjera:
    - një deklaratë të përgjithshme që përshkruan se janë ndërmarrë veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
    - informacion të qartë për pasojat konkrete të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për grupin përkatës të interesit, në mënyrë që të promovojë siguri dhe parashikueshmëri.
  - iii. përcakton kur është i nevojshëm komunikimi me grupet e interesit;
  - iv. identifikon përgjegjësin për komunikim ose sipas rastit, njësinë përgjegjëse për shpërndarjen e mesazhit;

<sup>38</sup> Informacionet që duhet të bëhen publike dhe kur duhet të bëhen

- v. identifikon kanalet efektive të komunikimit dhe infrastrukturën që nevojitet për zbatimin e strategjisë së komunikimit dhe mesazheve përkatëse;
- d. hartojë mesazhet kryesore përmes zhvillimit të dokumenteve standarde dhe postës elektronike, pyetjeve të bëra shpesh dhe mjeteve të tjera (p.sh. krijimi i *call center* sipas rastit *ad hoc*) për t'u përdorur gjatë procesit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- e. identifikojë çdo komunikim me pjesëmarrësit e tregut që mund të kërkohet në bazë të legjislacionit në fuqi.

#### Parimi G.2-Qeverisja e komunikimit

Banka përcakton procedura qeverisjeje që sigurojnë zbatim efektiv të planit të komunikimit në koordinim të ngushtë me ANJ-në.

Banka pritët të:

- a. sigurojë që pritshmëritë e përcaktuara në Parimin G.1 përfshihen në proceset e qeverisjes;
- b. përcaktojë përgjegjësitë për hartimin dhe zbatimin e planit të komunikimit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme (d.m.th. njësinë / funksionin përgjegjës);
- c. përcaktojë një proces miratimi që mbulon të gjitha dimensionet e planit të komunikimit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, duke përfshirë miratimin përfundimtar të tij, që siguron shpërndarjen e mesazheve uniforme;
- d. sigurojë që punonjësit përkatës janë të vetëdijshëm për rolet e tyre në drejtim të komunikimit me grupet e interesuara të identifikuara në situata krize, në koordinim me ANJ-në;
- e. ketë marrëveshje që sigurojnë konfidencialitetin për kërkesat e lartpërmendura;
- f. sigurojë që është vënë në dispozicion infrastruktura dhe burimet e nevojshme për komunikim efektiv me grupet e identifikuara të interesit. Këtu përfshihet infrastruktura standarde e komunikimit në situata normale biznesi si dhe infrastruktura e krijuar për ndërhyrjen e jashtëzakonshme (p.sh. përfshirja e kompanive të marrëdhënieve me publikun, vendosja e kapaciteteve shtesë të *call center* për të përballuar një vëllim të shtuar të komunikimit);
- g. përcaktojë procedura për publikimin e informacionit të nevojshëm sipas kërkesave ligjore.